



web  
[www.moraca-rozafa.org](http://www.moraca-rozafa.org)



**SHOQATA E PAKICES KOMBETARE  
SERBO-MALAZEZE  
MORAÇA-ROZAFA**

“ - ”



Shoqata “ Moraça-Rozafa” është promotorja dhe mbrojtësja e të drejtave dhe lirive të pjesëtarëve të pakicës serbo-malazeze në Shqipëri, kryen advokacinë e interesave të popullit të kësaj komuniteti ndërkombëtar, mban kontakte të vazhdueshme me organet shtetërore të Republikës së Serbisë dhe Republikës së Malit të Zi, informon mbi nivelin e respektimit të të drejtave të pakicës sone

**Kontakte**  
Shoqata “Moraça-Rozafa”  
Adresa:L.Partizani,  
Rr. Tregu i Ri, Shkoder,  
Albania  
tel/fax. +355 224 8866  
Mob. +355 69 21 39741  
mail:  
moraca\_rozafa@hotmail.com  
,office@moraca-rozafa.org

### Historiku

Shoqata është formuar në vitin 1992 si institucion për bashkimin e popullsisë serbe dhe malazeze që jeton në Shqipëri, me qëllim forcimin e identitetit kombëtar, promovimin e edukimit në gjuhën amtare, e kulturës dhe traditave, përfaqësimit mediatik, përmirësimit dhe kushteve të jetesës dhe punës të popullit serbo-malazëz dhe realizimin e përfaqësimit politik të pakicës sone në të gjitha nivelet e pushtetit

## EKONOMIA

- ✍ Grumbullimi dhe shpërndarja e materialeve reklamuese mbi ekonominë e Serbisë.
- ✍ Ndertimi i bazës së të dhënave mbi firmat shqiptare të cilat synojnë të bashkëpunojnë ekonomikisht me firmat nga Serbia.
- ✍ Kryerja e shërbimeve të perkthimit të materialeve për firmat serbe dhe shqiptare.
- ✍ Vendosja e kontakteve dhe ndërmjetësimi i firmave të interesuara për bashkëpunim reciprok.
- ✍ Promovimi i mundësive të investimit në Serbi, ofrimi i informacioneve mbi kornizën ligjore ekonomike të Serbisë dhe Shqipërisë dhe i asistencës për hapjen e përfaqësive të firmave.
- ✍ Mundësimi i punësimit të personave që zotërojnë njohuri të gjuhës serbe dhe shqipe.
- ✍ Organizimi i eskursioneve të biznesmënëve nga të dyja vendet në fabrikat dhe zonat industriale.
- ✍ Mbrojtja e të drejtave të autorit nëpërmjet juristëve dhe avokateve të tane.
- ✍ Ndermjetësimi për organizimin e ekspozitave dhe panairëve ekonomike të të gjitha llojeve.
- ✍ Ndermjetësim për blerje ose qeramarrje të tokës ose të ambienteve të biznesit.
- ✍ Krijimi i hapësirës për vendosjen e materialeve publicitare për firmat dhe donatorët në faqen e internetit të Qendres



## KULTURA

- ✍ Informacione rreth zhvillimeve kulturore, politike dhe ekonomike në Republikën e Serbisë për të gjithë të interesuarit.
- ✍ Hapja e Bibliotekës dhe arkivit mbi historinë, kulturën dhe letërsinë bashkëkohore të Serbisë dhe Malit të Zi, traditave qytetare, origjinës kombëtare, trendet e shoqërisë serbe në rrugën drejt integritit evropian.
- ✍ Lidhja dhe bashkëpunimi me organizatat qeveritare dhe joqeveritare serbe dhe malazeze në fushën e kulturës, mbrojtës të trashëgimisë dhe traditave kulturore të popullit të kësaj komuniteti, realizimi dhe financimi i projekteve të kërkimeve dhe rikonstruksioneve të objekteve fetare dhe kulturore, ngushtësisht të lidhura me historinë e popullit të kësaj komuniteti në Shqipëri.
- ✍ Krijimi i bashkëpunimit dhe mbajtjes së kontakteve me shoqëritë kulturore në Serbi, Mal të Zi dhe në bote, të cilat promovojnë kulturën dhe traditën e popullit serb me qëllim organizimin e shfaqjeve të përbashkëta në fushat e muzikës, sportit dhe artit, si dhe pjesëmarrjen e trupave teatrale dhe ansambleve të ndryshme.

